



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit  
të Kosovës**

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviç  
10 000 Prishtina

# RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

**Prishtinë, 23.03.2026**



Në bazë të nenit 20, alineja 1.3. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në mbledhjen e datës 23.03.2026 në Prishtinë, e ka miratuar këtë:

## **RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS**

### **Neni 1 - Dispozita të përgjithshme**

- 1.** Bordi i FBK-së është organi më i lartë ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës.
- 2.** Kryetarin, 2 nënkryetarët dhe nëntë anëtarë të Bordit të FBK-së i zgjedhë Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, ndërsa tre anëtarë tjerë të Bordit i emëron Kryetari i Bordit të FBK-së, në pajtim me Statutin e Federatës së Basketbollit të Kosovës.
- 3.** Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi apo dorëheqja e anëtarëve të Bordit të FBK-së bëhen në pajtim me Statutin e FBK-së dhe aktet tjera normative të FBK-së.
- 4.** Për punën dhe funksionimin e vet, Bordi i FBK-së i përgjigjet Kuvendit të FBK-së.

### **Neni 2 - Përgjegjësitë e Bordit**

- 1.** Bordi i FBK-së obligohet që t'i kryejë të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga Statuti dhe aktet tjera normative të Federatës së Basketbollit të Kosovës.
- 2.** Në pajtim me Statutin e FBK-së, Bordi i FBK-së ushtron përgjegjësitë në vijim:
  - 2.1.** Merr vendimin për konvokimin e mbledhjes së Kuvendit dhe propozon rendin e ditës për të;
  - 2.2.** Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera që i miraton Kuvendi;
  - 2.3.** Nxjerr Rregulloren për licencimin e klubeve dhe shkollave të basketbollit;



- 2.4.** Ekzekuton vendimet, konkluzionet dhe politikat e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi;
- 2.5.** Nxjerr rregullore tjera të brendshme që nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Federatës;
- 2.6.** Përpilon planin e punës dhe planin financiar vjetor të Federatës;
- 2.7.** Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës;
- 2.8.** Emëron dhe shkarkon Komesarin/ët e Garave. Komesari/ët e Garave do të votohen nga Bordi pas çdo edicioni, pas raporteve të punës;
- 2.9.** Emëron dhe shkarkon Drejtorët në Federatë;
- 2.10.** Formon trupa punuese të veta dhe emëron dhe shkarkon anëtarët e tyre. Sipas nevojës edhe miraton Rregulloret përkatëse për këta trupa punues;
- 2.11.** Përcakton strukturën organizative të Federatës, duke miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës;
- 2.12.** Disponon me pasurinë e Federatës;
- 2.13.** Miraton listën e zyrtarëve të autorizuar për ndeshjet e zhvilluara nën ombrellën e Federatës (gjyqtarë, vëzhgues, kontrollorë) dhe cakton lartësinë e taksës për zyrtarët e ndeshjeve;
- 2.14.** Miraton propozicionet dhe kalendarin e garave;
- 2.15.** Shqyrton dhe miraton plan programin e Këshillit Profesional dhe Rregulloren për Punën e Reprerentacioneve të Federatës;
- 2.16.** Bartë të drejtën e organizimit të garave nën kompetencë Federatës;
- 2.17.** Miraton Rregulloren e Garave të Federatës dhe cakton lartësinë e kootizimit për klubet dhe lartësinë e pagesave për shërbimet të cilat i kryen Federata për klubet;
- 2.18.** Miraton Rregulloren për Kalimin dhe Regjistrimin e Lojtarëve;
- 2.19.** Miraton Rregulloren Disiplinore;



- 2.20.** Miraton sistemin e garave për të gjitha kategoritë;
- 2.21.** Nominon klubet - ekipet që garojnë në gara ndërkombëtare në të gjitha grup moshat dhe të dyja gjinitë;
- 2.22.** Mban të drejtën e përjashtimit nga garat vendore dhe pezullimit të anëtarësisë në federatë për klubet që marrin pjesë në gara ndërkombëtare pa lejen e Bordit, gara ndërkombëtare që nuk njihen nga FIBA dhe gara tjera vendore ose ndërkombëtare ku FBK nuk përfaqësohet zyrtarisht;
- 2.23.** Themelon Komitetin Ekzekutiv të Federatës;
- 2.24.** Miraton Rregulloren mbi të drejtat dhe transmetimet audio vizuale;
- 2.25.** Miraton Rregulloren për agjentë/kompanitë e kontraktuara për sponsorizim të FBK-së;
- 2.26.** Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe përkohshme në Federatë, dhe lartësinë e pagave të tyre;
- 2.27.** I raporton Këshillit Mbikëqyrës mbi veprimtarinë e vet dhe mbarëvajtjen ligjore dhe financiare të Federatës, së paku dy herë në vit;
- 2.28.** Miraton Rregulloren për Shpalljen e Laureatëve të Vitit në Basketboll;
- 2.29.** Miraton Rregulloren e Anti-Dopingut;
- 2.30.** Miraton Politikat Mbrojtëse të FBK-së, dhe
- 2.31.** Miraton Kodin Etik të FBK-së.

**3.** Bordi mund të kryejë edhe funksione tjera të cilat i delegohen nga Kuvendi, si dhe të gjitha funksionet të cilat shprehimisht me këtë Statut apo me aktet tjera normative të Federatës apo me legjislacionin në fuqi nuk i delegohen Kuvendit të Federatës apo ndonjë organi tjetër kompetent.



### Neni 3 - Delegimi i kompetencave të Bordit

1. Bordi i FBK-së mund të krijojë këshille dhe komisione *ad hoc*, në rast se të njëjtat konsiderohen si të domosdoshme për funksionimin e tij. Në rast të tillë, Bordi do t'ua përcaktojë të atyre detyrat, kohë gjatësinë, kompetencat dhe fushë-veprimtarinë funksionale. Puna në trupa të tilla punuese do të zhvillohet në analogji me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Bordi i FBK-së mund t'ia delegojë kryerjen e një detyre edhe një personi të vetëm.
3. Bordi i FBK-së mund t'i autorizojë punonjësit administrativ apo profesional të FBK-së që të kryejë ndonjë punë që është nën kompetencën e Bordit të FBK-së.

### Neni 4 - Sekretari i Bordit të FBK-së

1. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së shërben edhe si Sekretar i Bordit të FBK-së dhe merr pjesë në të gjitha takimet e tij.
2. Sekretari i Bordit të FBK-së është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e Bordit, për mbarëvajtjen e korrespondencës me shkrim mes Bordit dhe anëtarëve dhe komisioneve të veta, dhe për dërgimin e ftesave dhe rendit të ditës tek anëtarët e Bordit.
3. Sekretari i Bordit të FBK-së është përgjegjës për formulimin e vendimeve të miratuara në Bord dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së Bordit të FBK-së.
4. Sekretari i Bordit të FBK-së është përgjegjës për mbajtjen e arkivit të Bordit të FBK-së.

### Neni 5 - Punimet e Bordit të FBK-së

1. Anëtarët e Bordit të FBK-së për mbledhjet e Bordit njoftohen përmes ftesave fizike dhe/ose elektronike, të cilat dërgohen së paku tre (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e Bordit të FBK-së duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.



- 2.** Rendi i ditës për mbledhjet e Bordit të FBK-së dhe ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të FBK-së, duhet t'i dërgohen të gjithë anëtarëve të të njëjtit së bashku me ftesën për mbledhjen e radhës.
- 3.** Të gjithë anëtarët e Bordit të FBK-së kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen vijuese. Kjo kërkesë duhet t'i parashtrahet me shkrim Kryetarit apo Sekretarit të Bordit, në formë fizike apo elektronike.
- 4.** Mbledhjet e Bordit të FBK-së i kryeson Kryetari i tij. Në mungesë të tij, me autorizim paraprak me shkrim, mbledhjet e Bordit mund t'i kryesojnë Nënkryetarët e FBK-së apo ndonjë anëtar i Bordit të FBK-së.
- 5.** Mbledhja e Bordit të FBK-së është e vlefshme për vendimmarrje në rast se janë të pranishëm së paku shumica e anëtarëve të Bordit. Në rast se një mbledhje nuk ka kuorum, Kryetari i Bordit është i detyruar të thërrasë mbledhjen e radhës brenda shtatë (7) ditëve kalendarike, me të njëjtin rend dite. Vendimet e miratuara pa kuorum nuk janë të vlefshme dhe nuk mund të ekzekutohen.
- 6.** Bordi i FBK-së mund të organizojë mbledhjet edhe në formë hibride ose online, kur rrethanat e jashtëzakonshme apo nevojat e veçanta të organizimit e kërkojnë një gjë të tillë. Pjesëmarrësit në këto mbledhje do të konsiderohen të pranishëm dhe me të drejtë vote, me kusht që të përdoren mjete teknologjike që sigurojnë identifikimin dhe pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe votim të sigurt dhe transparencë.
- 7.** Në mbledhjet e Bordit të FBK-së, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtarë ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 (dy) minuta. Kryesuesi i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Bordit të FBK-së.
- 8.** Bordi i FBK-së mund të ftojë ekspertë të jashtëm, përfaqësues të klubeve, juristë, ose përfaqësues të sponsorëve, për të marrë pjesë në mbledhjet e Bordit pa të drejtë vote. Kryetari i Bordit vendos për ftesën e palëve të treta





- 2.** Propozimet për nxjerrjen e vendimeve sipas formës së përcaktuar në nën paragrafin b) të paragrafit 1 të këtij neni i bën Kryetari i Bordit të FBK-së, ndërsa i administron Sekretari i Bordit të FBK-së.
- 3.** Të gjitha vendimet e Bordit të FBK-së konsiderohen të ekzekutueshme vetëm pas nënshkrimit nga Kryetari i FBK-së.
- 4.** Sekretari i Bordit është përgjegjës për hartimin, verifikimin, arkivimin dhe shpërndarjen e vendimeve të miratuara.
- 5.** Të gjitha vendimet e Bordit duhet të publikohen në ueb faqen zyrtare të FBK-së në mënyrë të qartë dhe të qasshme për publikun. Të gjitha vendimet e Bordit që lidhen drejtpërdrejt me palë të tjera (p.sh. klube, lojtarë, komisione, sponsorë) duhet t'u dërgohen atyre brenda tre (3) ditëve nga data e miratimit.

## Neni 7 - Konflikti i Interesit

- 1.** Çdo anëtar i Bordit të FBK-së është i detyruar të deklarojë cilindo konflikt të mundshëm interesi, direkt ose indirekt, që lidhet me vendimmarrjen në mbledhjen e Bordit.
- 2.** Në rast të ekzistencës së konfliktit të interesit, anëtari në fjalë duhet të:
  - 2.1.** lajmërojë Kryetarin dhe Sekretarin e Bordit përpara se të diskutohet pika përkatëse;
  - 2.2.** të përjashtohet nga diskutimi dhe votimi për atë pikë.
- 3.** Deklarimet e konfliktit të interesit duhet të regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.
- 4.** Shkelja e këtij neni konsiderohet shkelje e Kodit Etik të FBK-së dhe mund të ketë pasoja sipas Statutit dhe akteve normative të FBK-së.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit  
të Kosovës**

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## Neni 8 - Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore e Punës së Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës hyn në fuqi në datën e miratimit nga Kuvendi i FBK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i Bordit të FBK-së.

Kryetari

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës



**Prishtinë, 23.03.2026**